



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ndryshimet klimatike” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni dhe Halit Valteri, Kujtim Gjuzi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Ardit Konomi dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Ornela Çuçi- Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Pëllumb Abeshi - Drejtor i Përgjithshëm

Klodiana Marika- Drejtoreshë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Niko Peleshi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, ora 12:00, datë 10.09.2019.

Sot në shqyrtim kemi një projektligj të rëndësishëm për ndryshimet klimatike. Relator është zoti Besnik Baraj. Të pranishëm kemi zëvendësministren e Mjedisit dhe Turizmit, zonjën Ornela Çuçi, Pëllumb Abeshi, drejtor i Përgjithshëm dhe

Klodiana Marika.

Meqenëse është një projektligj i gjatë dhe i rëndësishëm dhe nuk e shterojmë të gjithin sot, propozoj të bëjmë prezantimin e ligjit nga relatori dhe nga përfaqësuesit e ministrisë, pyetje, diskutime dhe pastaj të vazhdojmë me votimin në parim dhe nën për nën në mbledhjen e radhës.

Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Pavarësisht se sot na vjen një ligj i plotë lidhur me ndryshimet klimatike, elemente të problematikës së ndryshimeve klimatike janë futur në axhendën e qeverive që në fillim të tranzicionit shqiptar. Ajo që unë kam vënë re në të gjithë këtë histori lidhet me një mospërputhje të ndjeshmërive reale me kuadrin ligjor, si dhe me forcimin e kapaciteteve qoftë për monitorimin, qoftë për raportimin e këtij sektori. Kuadri ligjor që rregullon marrëdhëniet me konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike është në fuqi përmes aktit ligjor të ratifikimit nga Republika e Shqipërisë së kësaj konvente, sipas së cilës vendi është palë e aneksit **jo 1** të saj me detyrime raportimi, por pa detyrime për reduktimin e gazrave me efekt serrë në atmosferë. Ky status i ka dhënë mundësinë Shqipërisë të përfitojë fonde nga GEF-i që të plotësojë detyrimin raportues dhe të dorëzojë në sekretariatit e konventës komunikimet kombëtare dhe në zhvillimet e mëvonshme raportet 2-vjeçare të përditësuara, kontributin kombëtar të përcaktuar dhe të tjera, që mund të vijnë si pasojë e zhvillimeve në konventë në interes të zbutjes së ndryshimeve klimatike me origjinë antropogjenike. Shqipëria ka dorëzuar me sukses tri komunikimet e para dhe është në proces të komunikimit të katërt të raportimit të parë dyvjeçar të përditësuar, i cili do të trajtojë gjerësisht ngritjen e kapaciteteve për sistemin kombëtar të monitorimit, verifikimit dhe raportimit, shkarkimeve gaz dhe serrë, politikave për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve të pritshme të klimës dhe fondeve të përfituara/harxhuara me qëllim të objektivave kombëtare.

Përveç ratifikimit të konventës janë miratuar dhe janë në fuqi edhe një seri aktesh nënligjore, VKM, strategjia kombëtare për ndryshimet klimatike, planet e veprimit, ngritja e grupit ndërministror për ndryshimet klimatike, përcaktimi i autoritetit kombëtar për protokollin e Kiotos, fondi i gjelbër i klimës e të tjerë.

Për mendimin tim, ligji është i pazbatueshëm, sepse me të gjitha aktet e miratuara deri sot Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në ngarkim me çështjet dhe ndryshimet klimatike, ka vetëm një ekspert të ri (do të thosha ndoshta pa përvojë) në detyrat funksionale, ku midis detyrave të tjera, ka diçka edhe për ndryshimet klimatike dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit askush nuk ka detyra që lidhen me ndryshimet klimatike. Nga ana tjetër, çdo veprim i deritanishëm, që ka të bëjë me analizat për ndryshimet klimatike, është bërë përmes projekteve, ndihmës së huaj dhënë ministrisë me ekspertë nga universitetet dhe akademia, por pa pjesëmarrjen e dëshirueshme nga vetë ministria dhe Agjencia e Mjedisit.

Ka mungesë të theksuar kapacitetesh, për më tepër udhëzuesit e hartuar nga konventa janë në transformim të vazhdueshëm, zhvillim që ndiqet pak nga struktura e dobët për ndryshimet klimatike në ministri. E njëjta gjë është edhe për skenarët klimatikë dhe analizat e vulnerabilitetit, masat për adaptim dhe skenarët e zbutjes, hartimi i të cilave kërkon kapacitete të plota, për të cilat luftohet fort nga projektet në ndihmë të ministrisë. Prej tre vjetësh nuk funksionon komiteti ndërministror për ndryshime klimatike (gjë që nuk është normale) i ngritur me VKM në vitin 2016, duke ulur shkallën e koordinimit me ministritë e linjës dhe aktorë të tjerë të interesuar në një nivel shumë bazik.

Për mendimin tim është e parakohshme të vihen kushte në lejet mjedisore, që parashikon edhe ligji, që për mua do të ishte një gjah tjetër që specialistët apo punonjësit poshtë do t'i bëjnë biznesit. Ato do të jenë gracka sikurse ndodh rëndom për procese të ndryshme në fushën e mjedisit apo në respektimin e elementeve të tjera ligjore. Më duket e parakohshme, sepse këto kushte, që kanë të bëjnë me shkarkimet e gazeve serrë, ne sot në projekt i përllogarisim duke u nisur vetëm nga të dhënat vjetore për aktivitetet në total, për shembull, sasia e lëndës djegëse e konsumuar, apo sasia e lëndës së parë të futur në linjat e prodhimit të çimentos. Ka shumë pak ekspertë që mund t'i shkojnë deri në fund procesit të përllogaritjes me një shkallë gabimi të pranuar. Të kërkojë detyrime llogaritjeje dhe të vësh gjoba për moszbatim nga subjektet private, kur ekspertët në agjencinë e mjedisit nuk kanë bërë vetë kurrë këtë ushtrim më parë, më duket e parakohshme dhe e panevojshme në këtë stad që jemi dhe, për mendimin tim, mund të ketë një frenim të zhvillimeve të ndryshme ekonomike industriale.

Pyetjet e mia janë:

Së pari, a keni një inventar të saktë të të gjitha projekteve, arritjeve në këtë sektor, në këta 25 vjet, për të përcaktuar qartë dhe saktë hapat që do të ndërmerrni? Janë hartuar strategji dhe plane, ku ka mjaft elemente që lidhen me klimën dhe unë kujtoj që në vitin 1996 ka pasur një plan në lidhje me këtë, ku kishte shumë elemente të ndryshimeve klimatike.

Së dyti, a është bërë një vlerësim i nevojave financiare për zbatimin e kuadrit ligjor në këtë sektor, pasi duhet një proces strikt monitorimi dhe raportimi? A jemi ne sot të gatshëm të ofrojmë burime njerëzore apo ekspertë për ta realizuar këtë?

Së fundi, a është bërë një studim lidhur me efektet që mund të ketë në zhvillimin ekonomik të vendit, në planin afatshkurtër, kur të adaptojmë këtë legjislacion?

Shpeshherë, gjë që nuk e kam vënë re në vendet fqinje, si: Kroacia, Sllovenia, Serbia, ne rendim menjëherë për të adaptuar ligjet, kjo për shkak se na i kërkon procesi në të cilin jemi futur, ai i integritetit të Bashkimit Europian, ndërsa vendet e tjera kanë një rezistencë në lidhje me ato ligje, të cilët mund të dëmtojnë zhvillimin ekonomik në etapat përkatëse që ato janë. Përkundrazi, ne jemi të parët që i miratojmë dhe, kur i miratojmë, vëmë re se çfarë efekti ekonomik ka kjo gjë. Kjo është vënë re kur jemi futur në OBT. Pra, dua që ministria të jetë plotësisht e ndërgjegjshme për përgjegjësinë dhe impaktin që ka ky ligj në zhvillimin ekonomik të vendit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Po, zonja Çuçi.

Ornela Çuçi – Faleminderit kryetar!

Faleminderit, profesor, për të gjithë shikimin e detajuar që i keni bërë projektligjit!

Unë, në fakt, dua ta filloj fjalën time nga nevoja që kemi ne për të reflektuar mbi ndryshimet klimatike si vend. Shqipëria është një nga vendet që impakton shumë pak ndryshimet klimatike, por ndërkohë është shumë e impaktuar nga ndryshimet klimatike. Raportet e fundit për ndryshimet klimatike për 198 vendet e OKB-së tregojnë se ne zëmë vendin e 44 për impaktimin nga ndryshimet klimatike dhe impakti shikohet në të gjitha qarqet, ku ju jeni përfaqësues, me erozion dhe me probleme të jashtëzakonshme nga përmbytjet. E gjitha kjo tregon që impakti i ndryshimeve klimatike na prek edhe ne. Ndryshimet klimatike nuk ndodhin në Arktikë dhe ngelen thjesht në Arktikë, por jemi ne që i pësojmë dhe për këtë duhet të reflektojmë më tepër. Në këtë kuadër, profesor ju keni të drejtë kur thoni që ne kemi pasur tri komunikime për emetimet e gazeve. Me këto tri komunikime, ajo që kemi vënë re nga analiza që është bërë deri sot në vendimmarrjet e të gjitha qeverive në këto 3 komunikime, duke nisur që nga viti 2003, në vendimmarrjet politike të qeverive të ndryshme nuk janë reflektuar rezultatet që dalin nga këto komunikime dhe se çfarë duhet të bëjnë qeveritë. Jemi duke bërë të katërtin aktualisht dhe reflektimi nga këto 3 komunikime dhe nga i katërti, për të cilin jemi duke punuar, ka të bëjë edhe me vendimmarrjen për këtë ligj. Nga këto 3 komunikime dhe nga planet që bëjmë gjatë gjithë kohës, sepse kemi që në

vitin 1996 që bëjmë plane, pastaj bëjmë plan të zbatimit të planit, pra të planit që nuk u vu asnjëherë në plan, jemi duke ndërhyrë më në thellësi për ta bërë sistemin më të qëndrueshëm, që këto plane të mos mbeten thjesht plane. Po ju jap vetëm një shembull, në këto momente ne jemi duke bashkëpunuar me universitetet për të bërë komunikimin e katërt dhe matjet e emetimit të gazeve në Republikën e Shqipërisë dhe po punojmë që për herë të parë që në Shqipëri të hapet një master shkencor në Universitetin Politeknik, me qëllim që të kemi ekspertë të mirëfilltë për ndryshimet klimatike në vend. Tashmë për ndryshimet klimatike flitet gjithkund dhe është fjala parësore e politikës së të gjitha vendeve. Në fakt, në Shqipëri nuk kemi specialistë të mirëfilltë për ndryshimet klimatike, sepse universitetet nuk nxjerrin specialistë të tillë.

Paralelisht me hartimin e projekteve të mëdha për ndryshimet klimatike, ne jemi duke punuar në mënyrë të qëndrueshme që të ndërtojmë ekspertizën tonë lokale, e cila do të mund ta ndihmojë vendin tonë sot dhe përgjithmonë për të reflektuar për ndryshimet klimatike dhe për të parandaluar problemet që kemi pasur.

Ju thatë që kemi vetëm një person përgjegjës në ministrinë tonë për ndryshimet klimatike. Kjo është shumë e vërtetë, ndërkohë jemi duke punuar për ristrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të parë dhe për ta mbushur këtë boshllëk që është krijuar.

Nga ana tjetër, Inspektorati (ju e dini që ka kaluar me VKM) do të shkrihet dhe do të ndahet në: Policinë e Shtetit, në Agjencinë e Mjedisit dhe në Agjencinë e Pyjeve, të cilat do të funksionojnë në të njëjtën mënyrë dhe do të krijojnë mundësi për të pasur ekspertizë të mirëfilltë për ndryshimet klimatike në këto institucione të reja. Në këtë kuadër, ekspertiza do të zhvillohet vetëm në universitet, që të mos kemi më njerëz të paformuar në ministri për këtë çështje, duke shkuar edhe në nivelet më të larta, pra duke i çuar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Ju thoni se është ligj i pazbatueshëm dhe ka ardhur shpejt në vendin tonë, mund të keni të drejtë, por, nëse ne nuk fillojmë me këtë bazë ligjore, nuk mund të reflektojmë asnjë lloj tjetër përparësie që kemi në vendin tonë për ndryshimet klimatike. Ky është një ligj kuadër dhe është ligji i parë që vjen për ndryshimet klimatike dhe do të pasohet edhe me të gjitha nënligjet përkatëse. Te këto të fundit do të sanksionohen institucionet dhe mënyra se si do të reflektohen. Ligji i detyron AKBN-në dhe AKM-n për të reflektuar mbi këtë ligj, por do të ketë edhe institucione të tjera për implementim e tij.

Një pikë tjetër, që kam shënuar, ka të bëjë me grackën për biznesin dhe a është ky i fundit në kushtet e lejes mjedisore? Zbatimi i lejes mjedisore është në varësi të kapaciteteve

që kemi aktualisht në Shqipëri. A po ngremë një grackë për biznesin? Jo, ky ligj nuk ngre një grackë të tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mungesë kapacitetesh, unë nuk mund të them se nuk do të bëj politikat e duhura për vendin tim, sepse në këtë mënyrë pengoj aderimin e vendit tim në BE, integrimin dhe kushtet që na janë vendosur në këtë fazë të *screening*-ut dhe raportimin tonë në konventat e OKB-së. Mosmarrjen e fondeve nga *Green Climate Fund* dhe nga *Global Environment Facility*, pra mosmiratimi i tyre, për më tepër mosmarrja e disa fondeve shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me IPA-t vjen për shkak se ne nuk kemi përmbushur kushtet që na janë vendosur për ndryshimet klimatike. Ndryshimet klimatike janë një nocion shumë i madh për Shqipërinë. Jam dakord për këtë, por kjo nuk do të thotë që të mos bëjmë asnjë përpjekje.

Besnik Baraj - Ndoshta jam keqkuptuar, kurrësi nuk mund të mendoj se ngrihen gracka nëpërmjet një kuadri ligjor. Këtu kam parasysh përvojat e deritanishme për mekanizëm të kësaj natyre që penalizojnë, për më tepër kur mungojnë kapacitetet për ta vlerësuar realisht këtë gjë. Pa dashur ju më dhatë edhe një argument, që është i parakohshëm. Ne do të fillojmë tani të përgatisim hapjen e masterit apo të baçelorit për ekspertët, por ky proces do të dojë të paktën 2-3 vjet. Ndoshta do të ishte mirë që hyrja në fuqi e këtij ligji të jetë minimalisht të paktën pas 1 viti dhe jo pas 6 muajsh.

Ornela Çuçi - Në fakt, unë nuk ju dhashë një grackë tjetër për veten, por jam duke thënë se po e bëjmë sistemin të qëndrueshëm. Ajo që kisha ndërmend të thosha lidhet me faktin se kush do ta zbatojë ligjin, sepse të paktën në 20 vjetët e fundit nuk ka një specialist në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe në AKM që nuk është trajnuar së paku 2-3 herë për ndryshimet klimatike. Ky është një koncept i ri që duhet ta përqasim të gjithë. Në këtë mënyrë është trajnuar vazhdimisht stafi për çështjet e ndryshimeve klimatike.

Ju thatë se kemi një sërë projektesh që janë dhënë deri tani, të cilat kanë prekur në fusha të ndryshme ndryshimet klimatike. Për këtë shkak kemi pasur ekspertizën e nevojshme në disa sektorë. Po ju jap vetëm një sektor, atë të energjetikës. Në këtë sektor kemi specialistë në Ministrinë e Energjetikës, por kemi edhe specialistë të Bankës Botërore që po ndihmojnë aktualisht të gjithë rajonin me specialitetin që kanë për çështjen e ndryshimeve klimatike në fushën e energjisë. Kjo tregon se kemi bërë shumë, por kemi nevojë që ta bëjmë më të qëndrueshëm sistemin, si dhe kemi nevojë për specialistë të rinj, por edhe për një kuadër ligjor, i cili do të mund të bëjë kaudratimin e të gjithë këtij sektori dhe të vendosë bazat në të.

Niko Peleshi – E mbyllim këtu. Herën tjetër do të vazhdojmë me pyetje-përgjigjet dhe diskutimet, pra do t'i shterojmë të gjitha, me qëllim që të mos biem në përsëritje. Do t'ju lutesha të vini përsëri, pasi do të fillojmë menjëherë me pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe me përgjigjet nga ana juaj. Pastaj do të kemi diskutimet, votimin në parim, nën për nën dhe në tërësi. Nuk e di nëse do të arrijmë ta mbyllim brenda mbledhjes së ardhshme.

Ornela Çuçi - Nëse mundet, do të ishte e udhës që komisioni të na paraqiste një listë të pyetjeve, pasi janë shumë teknike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për pyetjet tuaja do të kem patjetër informacion në çdo moment.

Niko Peleshi - Meqenëse zotit Sinaj po insiston për dy pyetje, ju lutem regjistroni që mbledhjen tjetër të vazhdojmë me pyetjet e tjera.

Vullnet Sinaj - Nisur edhe nga referimi i zotit Baraj, pyetja e parë është: në cilin vend tjetër të rajonit në Ballkan është bërë realitet dhe është implementuar ky lig për të kuptuar nëse ekonomia dhe industria e vendit tonë do të vihet përballë ekonomisë së një vendi tjetër, që mund të ketë rregulla me më pak kërkesa që mund të ndikojë në konkurrencë dhe mund të rrisë importet në vend?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta mbaroj edhe pyetjen e dytë!

Pyetja e dytë: ju si ministri a keni punuar me bizneset për këtë ky projektligj? A është diskutuar që edhe ata të bëhen ndërgjegjshëm për të marrë masat që të mos i gjejë ligji në befasi?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Mbledhja e radhës do të njoftohet me e-mail dhe me WhatsApp.

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA